

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 27 JANAR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

A e dini si u tall një kolege e opozitës teksa e diskutonim këtë projekt në Komisionin e Ligjeve? “Paskeni gjetur dy fjalë magjike, - tha, - “integritet dhe besueshmëri profesionale e do të na rregulloni noterinë”. Dhe, në fakt, më kujtoi fjalët e një burri të mençur, i cili thotë: “Tallemi me ndershmërinë dhe tronditemi se nga na mbijnë tradhtarët në mesin tonë”. Në fakt, kolegja vetëm sa vuri gishtin në plagë, në plagën e vjetër të noterisë, madje të të gjitha shërbimeve të lira, në mungesën e besimit. E, në fakt, si mundet t’i besojë qytetari një noteri, që “Po-së” i thotë “Jo”?! Si mundet t’i besojë prindi një noteri, që gënjeshtren e ka zgjedhur si stil jetese?! Si mundet t’i besojë noterit pala, kur kontratat që ai nënshkruan, nuk i beson as vetë dhe si mundet t’i besojë noterit ortakët që ai ose ajo i lidh në pabesi? Këta lloj noterësh thjesht brutalizojnë profesionin e tyre, u ngulin thika pas shpine kolegëve të tyre, shkatërrojnë komunitetin e tyre, katandisin një bashkësi të mirorganizuar në xhungël, shqyejnë stofin shoqëror dhe profesional që i mban së bashku ata dhe të gjithë shoqërinë. Shërbimi noterial themelohet mbi besimin. Është besimi “te noteri dhe para noterit” që magjeps dy të panjohur dhe i kthen në bashkëpunëtorë të ngushtë. Është besimi “te noteri dhe para noterit” që vë në punë instrumentet e ndjeshëm të tregtisë dhe të ligjit. Është besimi “te noteri dhe para noterit” që lëviz shoqërinë tonë globale, digjitale dhe konfidenciale, ndaj projekti që shqyrtojmë sot është i një rëndësie të veçantë. Integriteti dhe besueshmëria profesionale nuk janë fjalë magjike, por janë kriteret bazë mbi të cilat nis detyra e noterit. Kur një notere përzgjidhet në detyrë, mbështetur mbi këto kritere, ajo e ka ngritur karrierën e saj mbi një themel të sigurt.

Pra, magjike nuk janë fjalët, por janë ndërgjegjja dhe jeta e kandidatëve për noterë, e noterëve, e avokatëve, e magjistratëve, pra e të gjithë profesionistëve të ligjit, të cilat, kur rrënjosen në integritet dhe në besueshmëri profesionale, shërojnë flamën e mungesës së besimit në sistemin e drejtësisë. Kjo është sfida jonë e përbashkët. Parashikimi në projektligj i shkeljeve disiplinore jashtë ushtrimit të profesionit parandalon depërtimin e kandidatëve dhe noterëve që harrojnë se janë kudo dhe kurdo nën sundimin e ligjit, ndërkohë që përfshirja në listën e masave kundër financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave dhe revokimit të licencës për arsytet e mësipërme, intensifikon luftën e shtetit ndaj krimit dhe pastrimit të parave dhe e çon në një nivel krejt tjetër. Respektimi i sundimit të ligjit, ruajtja e integritetit të marrëveshjes dhe sigurimi i origjinalitetit të transaksionit janë themelet e shërbimit noterial që synon të forcojë ky projekt. Një profesion dhe sistemi noterial, i ngritur mbi integritetin dhe besueshmërinë profesionale, qëndron larg veprimtarisë kriminale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Vetëm një shërbim i tillë dallon dokumentet e noterizuara nga mijëra dokumente të tjera që janë në qarkullim.

Profesionin e lashtë dhe fisnik të noterit e mban në këmbë vetëm integriteti dhe besueshmëria profesionale. Mbi këto shtylla ngrihet procesi që zyrtarizon dokumente dhe i bën të denja për besimin e publikut, mbi këto shtylla qëndron siguria e origjinalitetit të tyre, mbi këto shtylla mbështetet vërtetësia e firmës së noterit, mbi këto shtylla ngrihet një sistem i tërë, që shqiptarët mezi po presin t’u japë besim, siguri dhe ligjshmëri.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar kolegë opozitarë,

Integriteti dhe besueshmëria juaj profesionale jua kërkon që të bashkoheni dhe ta votojmë së bashku këtë ligj. Këto ndryshime përmbushin detyrimin jo vetëm ndaj qytetarëve shqiptarë, por edhe ndaj partnerëve tanë ndërkombëtarë. Ndaj, nëse nuk doni ose nëse nuk dini të ofroni kontribut në ligjvërje, bëni siç thonë anglezët, “komentoni motin” dhe në rastin tuaj, komentoni dimrin e madh që ju ka kapluar. Faleminderit!